



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr.78 , datë 24.2.2020

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE PËR
EMËRIM NË GJYKATËN E LARTË, PËR KANDIDATIN Z. {...} DHE PËRJASHTIMIN
E TIJ NGA PROCEDURAT E MËTEJSHME TË KANDIDIMIT PËR POZICIONIN E
LIRË, NË FUSHËN E TË DREJTËS ADMINISTRATIVE, TË SHPALLUR ME
VENDIMIN NR.108, DATË 09.07.2019,
TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

I. PROCEDURA E VLERËSIMIT DHE PIKËZIMIT

1. Me Vendimin nr.108, datë 09.07.2019, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “*Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës administrative”.*

2. Brenda afatit të përcaktuar dyjavor nga dita e publikimit të vendimeve si më lart në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. {...} ka aplikuar për të marrë pjesë në procedurën e konkurimit për pozicionet e lira të shpallura përmes vendimeve të mësipërme.

3. Me Vendimin nr. 142, datë 26.07.2019, bazuar në nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur :

1. *Fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatët, nga radhët e juristëve të spikatur, për në pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë.*

2. *Caktimin e relatorit për secilin kandidat që ka dorëzuar kërkesën për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë, konkretisht për z. {...} - relatore znj. Marçela Shehu; ...”.*

3.1 Me Vendimin nr. 182, datë 02.10.2019, bazuar në pikën 7, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndër të tjera, ka vendosur: “Për kandidatët ... z.{...}, ..., të cilët

kanë aplikuar edhe për pozicionet shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 108, nr. 109 dhe nr. 110, datë 09.07.2019, procedurat e verifikimit që janë në proces e sipër për këto kandidime, janë të vlefshme edhe për kandidimin e tyre për pozicionin e lirë të shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 172, datë 11.09.2019”.

4. Më datë 26.07.2019, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidati, z. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua: - *për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidati u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.*

5. Brenda afatit tregues, kandidati z. {...}, depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidati nuk parashtrroi asnjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

6. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

7. Në përfundim të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të emërimit, të pasurisë dhe të figurës të kandidatit z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 255, datë 12.11.2019 “Për kualifikimin e kandidatit jogjyqtar z. {...} dhe vijimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim si gjyqtar në Gjykatën e Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: *“1. Kualifikimin e kandidatit jogjyqtar z. {...} dhe vijimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim si gjyqtar në Gjykatën e Lartë për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 108, datë 09.07.2019, të Këshillimit të Lartë Gjyqësor.*

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve...”.

8. Bazuar në Kreun V, seksioni A, pika 1) të Vendimit nr. 102, datë 05.07.2019, procedura e përzgjedhjes së kandidatëve për emërim në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë, fillon me vendim të Këshillit jo më vonë se 7 ditë, nga vendimi i parë përfundimtarë i Këshillit për kualifikimin për emërim të një kandidati për atë pozicion të lirë. Me vendimin nr. 260, datë 13.11.2019 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 108, datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: *“1. Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 108, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

2. Caktimin e z. Alban Toro si relator për procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 108, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor... ”.

9. Më datë 30.1.2020, bazuar në parashikimet e Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”, kandidati, në rrugë elektronike, i ‘u me dije se ka të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Gjithashtu, bazuar në vendimin e sipërcituar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i ‘u bë me dije se ka detyrimin të dorëzojë në zyrën e posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e njoftimit, listën e dokumenteve, në origjinal ose të vërtetuar sipas ligjit.

10. Në lidhje me njoftimin si më sipër, kandidati z. {...} mori dijeni në rrugë elektronike nga Relatori për njoftimin më datë 30.01.2020.

11. Brenda afatit 3 (tre) ditor nga ajo e njoftimit si më sipër, kandidati nuk parashitroi kërkesë për përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit.

12. Brenda afatit 7 (shtatë) ditor, nga ajo e njoftimit publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit në lidhje me caktimin e relatorit për procedurën përkatëse të përzgjedhjes së kandidatëve për pozicionin e lirë, kandidati z. {...} dorëzoi në rrugë elektronike dokumentet e nevojshme për përzgjedhjen, vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve sipas përcaktimeve të Ligjit dhe Vendimit nr. 102 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

13. Më datë 20.2.2020, kandidati z. {...} depozitoi kërkesën nr. 4666/3 prot., pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me lëndë “ Kërkesë për tërheqje nga kandidimi për vendin vakant të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë në fushën e të drejtës administrative shpallur me Vendim 108 datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

14. Në Mbledhjen e datës 20.2.2019, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu V, të Vendimit të tij nr.102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për përfundimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për emërim në Gjykatën e Lartë dhe procedurat e mëtejshme të kandidimit për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.108, datë 09.07.2019

II. TËRHEQJA NGA KANDIDIMI DHE VLERËSIMI I SAJ

1. Duke u mbështetur në dispozitat Kushtetuese, ligjin specifik dhe nënligjore të zbatueshme për çështjen në shqyrtim si edhe nga aktet që janë të depozituara në dosjen personale të kandidatis në mënyrë të veçantë aktin e dorëheqjes nga kandidimi nr. 4666/3 prot., datë 20.2.2020, të z. {...}, vlerëson se procedura e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë dhe procedurat e mëtejshme e kandidimit për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës administrative, të këtij të fundit ndërpriten për shkak të dorëheqjes së tij.

2. Bazuar në faktin e tërheqjes nga kandidimi, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se një tërheqje e tillë është e drejtë ligjore e kandidatis z. {...} e sanksionuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu

V, të Vendimit të tij nr.102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”.

2.1 Konkretisht, sipas pikës 8, Seksioni B, Kreu V, të këtij Vendimi, **“Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi derisa Këshilli nuk ka përfunduar procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për emërim, duke njoftuar për këtë, me shkrim, Këshillin. Pas këtij njoftimi, me propozim të relatorit të çështjes, përcjellë nga Komisioni, Këshilli vendos menjëherë përfundimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për emërim për këtë kandidat dhe përjashtimin e tij nga procedurat e mëtejshme të kandidimit. Akti i Këshillit për përfundimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për emërim të këtij kandidati dhe përjashtimin e tij nga procedurat e mëtejshme të kandidimit, i njoftohet menjëherë kandidatit dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit.”.**

2.2 Konkretisht, në këtë rast është mbajtur parasysh përcaktimi i bërë në nenin 94 (“Tërheqja e kërkesës ...”), pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit **“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.”.** Komisioni në zbatim të drejtë të dispozitave ligjore dhe atyre nënligjore të zbatueshëm në rastin e dorëheqjeve gjatë kandidimit vlerëson të rregullt qartësinë e vullnetit të shprehur, *expressis verbis*/aktin nr. 4666/3 prot., datë 20.2.2020, prej këtij kandidati dhe si të tilla e konsideron atë si një të drejtë që ushtrohet nga ai në çdo moment dhe që bazohet ekskluzivisht mbi vullnetin individual të tij duke respektuar procedurat, kushtet dhe kriteret e kandidimit që parashikojnë aktet rregullatorë të sipërcituara. Në çdo fazë e gjendje procedimi administrativ, kur kandidati shpreh vullnetin për të mos vijuar me tek konkurrimin, nuk ka vend për të vijuar me tek procedurat e vlerësimit, të pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës të parashikuar nga dispozitat ligjore dhe aktet e nxjerra në zbatim të tyre.

3. Në referim të situatës së faktit dhe parashikimeve të sipërcituara të Vendimit nr. 102, datë 05.07.2019 të KLGJ-së, Këshilli vlerëson se jemi në kushtet e përfundimit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatit për emërim në Gjykatën e Lartë për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës administrative, z. {...}

III. KONKLUZIONE

Sa më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në konkluzionin se kandidati, z. {...}, ka shprehur vullnetin për t’u tërhequr nga kandidimi dhe për mos vazhdimin e mëtejshëm të procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë, në fushën e të drejtës administrative, prandaj Këshilli është përpara rastit për të vendosur përfundimin e procedurës për emërim për këtë kandidat.

PËR KËTO ARSYE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, i mbledhur më datë 24.2.2020, bazuar në nenet 61, 97, 98 dhe 100 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikën 3, të nenit 90 dhe nenin 94 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në pikën 8, Seksioni B, Kreu V, të Vendimit të tij nr.102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”, mbi kërkesën e datës 20.02.2020 të kandidatit z.{...} për tërheqjen nga kandidimi, me propozimin e relatorit të çështjes,

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për emërim në Gjykatën e Lartë, për kandidatin z. {...} dhe përjashtimin e tij nga procedurat e mëtejshme të kandidimit për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin nr.108, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR